



RAPORT HULUMTUES

Si të menaxhohet problemi i papunësisë tek komuniteti serbë?

MILENIUMI I RI
Tetor 2006

Emri i projektit:
PAPUNËSIA S'I TË MENAXHOHET...?

Raport hulumtues
SI TË MENAXHOHET PROBLEMI I PAPUNËSISË
TEK KOMUNITETI SERBË?



Projekti u implementua nga:
MILENIUMI I RI



Projekti u mbështet
financiarisht nga FDI

MILENIUMI I RI
Tetor 2006

Nehat Bllacaku

Drejtor Ekzekutiv

Faton Morina

Menaxher i Projekteve

Enver Hasangjekaj

Koordinator Hulumtues i Projektit

Adresa

10000 Kosovë-Prishtinë

Dardania, Rruga : "Lekë Dukagjini"

Objekti i Bashkësisë Lokale #3

Telefon : +377 (0) 44 307 533

E-mail: ojqmileniumiiri@yahoo.com

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	6
1.1. Historik i shkurtër për Mileniumin e Ri.....	6
1.2. Përshkrim i shkurtër i projektit.....	8
2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	9
2.1. Analizë e shkurtër mbi rëndësinë e trajtimit të fenomenit të papunësisë në Kosovë.....	9
2.2. Procesi i privatizimit- ndikimi në zbutjen e papunësisë.....	11
3. QËLLIMI.....	13
3.1. Qëllimi i raportit.....	13
4. MBLEDHJA E TË DHËNAVE - METODOLOGJIA.....	14
5. PREZANTIMI I REZULTATEVE.....	15
5.1. Regjioni i Gjilanit.....	16
5.2. Regjioni i Ferizajt.....	19
5.3. Regjioni i Prizrenit.....	21
5.4. Regjioni i Mitrovicës.....	23
5.5. Regjioni i Pejës.....	26
5.6. Regjioni i Prishtinës.....	27
6. REKOMANDIME.....	28

1. HYRJE

1.1. Historik i shkurtër për organizatën “Mileniumi i Ri”

Mileniumi i Ri- është themeluar në vitin 2001. Që nga atëherë ka punuar në disa fusha siç janë: Mjedisi (ambienti), Çështjet sociale, Pajtim ndëretnik, Politikat publike dhe Punësim.

Vizioni:

Vizioni ynë është që të jemi promotor i zhvillimit dhe ndërtimit të shoqërisë civile në Kosovë.

Misioni

Mileniumi i Ri është organizatë jo-fitimprurëse e cila punon për të forcuar rolin e shoqërisë civile në Kosovë, me qëllim të shtytjes së proceseve pozitive përpara, nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, pasqyrimin e transparencës në institucionet publike, luftimin e dukurive negative në shoqëri dhe avokimin e vazhdueshëm për të drejtat qytetare dhe çështjet me interes publik.

Objektivat:

- Të avancoj rolin dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile (OJQ-ve) në Kosovë në të gjitha proceset shoqërore të cilat janë më interes për shoqërinë kosovare;
- Të punoj në drejtim të eliminimit të dukurive negative në shoqëri, siç janë: korrupsioni, nepotizmi, klientelizmi dhe dukuri të tjera negative të cilat janë të pranishme në shoqërinë tonë;
- Përmes projekteve të ndryshme ta pasqyroj dhe në këtë mënyrë ta rrisë transparencën në të gjitha institucionet tona publike;
- Përmes hulumtimeve të ndryshme të bëjë informimin e qytetarëve lidhur me çështje të ndryshme me interes për ta;
- Të bëjë monitorimin, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e punës së institucioneve tona si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror;
- Të avokoj për të drejtat e njeriut dhe për çështje të tjera të rëndësishme për shoqërinë në përgjithësi;
- Të promovoj një frymë tolerante ndëretnike përmes pjesëmarrjes apo realizimit të projekteve që kanë të bëjnë më të drejtat e komuniteteve pakicë dhe integritet të tyre në jetën shoqërore në Kosovë;
- Të promovoj dhe afirmoi idenë e Filantropisë dhe Voluntarizmit në Shoqërinë Civile në Kosovë;
- Të realizoj edhe aktivitete të tjera që ndikojnë në përmirësimin e jetesës, arsimimit dhe zhvillimit të përgjithshëm të vendit dhe shoqërisë civile në përgjithësi.

Aktivitetet kryesore të realizuara deri më tani

Aktivitetet fillestare ishin ato për mjedisin dhe dukuritë negative të realizuara në bashkëpunim me organizata dhe institucione tjera.

Hovet e zhvillimit MILENIUMI I RI i arriti në tetor dhe nëntor 2003. Gjatë këtyre muajve është realizuar fushata për mjedisin: “Të gjithë për një ambient më të mirë” e financuar nga Qendra Regjionale e Mjedisit (REC), Agjencioni Suedez për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Ky projekt u cilësua s’i projekti më i mirë i vitit në lëmin e mjedisit.

Në qershor të vitit 2004 MILENIUMI I RI bashkë me organizatën rinore “Etika” dhe me disa donator tjerë realizuan projektin me rastin e 5 vjetorit të hyrjes së forcave të NATO-së në Kosovë. Projekt ky i cili kishte për qëllim përkrahjen e mëtutjeshme të forcave ndërkombëtare pas trazirave të dhunshme të marsit dhe me rastin e 5 vjetorit të hyrjes së tyre në Kosovë.

Gjatë muajit gusht dhe shtator 2004 me përkrahje nga Departamenti i Rinisë dhe disa organizatave tjera MILENIUMI I RI realizoi projektin: “Ndihmë atyre që kanë nevojë”, i shtrirë në 6 komunitet e regjionit të Prishtinës. Nga ky projekt përfituan ndihmë më shumë se 200 familje nevojtare. Ky projekt po ashtu ishte projekti më i suksesshëm në mesin e 5 projekteve të njëjta në Kosovë.

Gjatë muajit nëntor të vitit 2004 MILENIUMI I RI dhe organizata rinore “Etika” realizuan projektin: “Dialogu Civil-Të rinjtë për paqe”, projekt ky i cili i financua nga: Shoqata Humanitare Bamirëse e Kosovës (SHHBK) “Nëna Terezë” dhe Rrjeti për Regjionalizim (RBF) nga Novi Sadi.

Aktualisht MILENIUMI I RI ka përfunduar projektin për politikën publike të prokurimit “Bashkë më mirë”, të financuar nga Fondacioni për Iniciativë Demokratike (FDI) në kuadër të Projektit të OJQ-ve kosovare për avokim (KNAP) që është marrëveshje ndërmjet USAID-it dhe EËMI-të. Organizata Joqeveritare “ MILENIUMI I RI “ nga data 17 Mars 2005 deri me datën 17 Prill 2005 ka realizuar një hulumtim me qytetarët e komunës së Prishtinës lidhur me punën e Kuvendit Komunal , si dhe me personat përgjegjës të Institucioneve publike, OJQ-ve lokale dhe Ndërmarrjeve të biznesit në nivelin lokal në komunën e Prishtinës

Struktura organizative

Kuvendi është organi më i lartë drejtues, ndërsa politikën vepruese i harton dhe mbikëqyrë Këshilli Drejtues i përbërë nga 5 anëtar me të drejtë vote.

1.2. Përshkrim i shkurtër i projektit

Projekti për hulumtimin e papunësisë së komunitetit serb, "Papunësia si të menaxhohet" është realizuar nga muaji mars-2006. Projekti u menaxhua nga Nehat Blacaku, ndërsa mbledhja e të dhënave është koordinuar nga Enver Hasangjekaj. Ky projekt ka për qëllim hulumtimin e të papunëve nga komuniteti serb në mbarë Kosovën, të promovoj mundësit e punësimit të tyre, në institucione dhe në ndërmarrjet e privatizuara. Gjithashtu në projekt do të përfshihet edhe mundësia e krijimit të bizneseve dhe ndërmarrjeve të vogla në rrethe të përziera dhe kreditimi i tyre nga ana e bankave komerciale të Kosovës apo donatorë tjerë.

Hulumtimi për gjendjen e papunësisë në komunitetin serb të Kosovës do të bëhet përmes disa hulumtuesve në teren, do të mblidhen mostrat për tu kompletuar në një raport të veçantë. Në raport do të përfshihen mundësit e punësimit të tyre në rrethet e ndryshme, në institucionet lokale, dhe në ndërmarrjet e reja të krijuara nga privatizimi. Në të njëjtën kohë këtu do të përfshihen edhe vendet ku ka mundësi të krijohen ndërmarrje dhe biznese të suksesshme të cilat në masë do ta zbusnin papunësisë, përmes kreditimit nga ana e bankave komerciale apo donatorëve tjerë. Duhet theksuar që projekti do të zbatohet në bashkëpunim me qendrat rajonale të punësimit, kuvendet komunale, ekspertet e ndryshëm dhe ndërmarrjet apo kompanitë e ndryshme në rajone.

Qëllimi i projektit

Qëllimi i projektit është Hulumtimi mbi gjendjen e papunësisë të komunitetit serb në Kosovë dhe promovimi i mundësisë së punësimit të tyre, duke përfshirë edhe promovimin e krijimit të ndërmarrjeve të bizneseve të vogla në rrethe të përziera.

Objektivat

Objektivat e projektit janë :

- Hulumtimi i gjendjes së papunësisë së komunitetit serb në Kosovë,
- Promovimi i mundësive të punësimit,
- Promovimi i krijimit të ndërmarrjeve dhe bizneseve në rrethe të ndryshme.

2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

2.1. Analizë e shkurtër rreth rëndësisë së trajtimit të fenomenit të papunësisë në Kosovë

Shoqëria kosovare si një shoqëri e dalë nga lufta është duke kaluar në një proces tranzicioni shoqëror i cili po përcjellët me probleme dhe sfida të shumta për shoqërinë kosovare. Një ndër problemet dhe sfidat me të mëdha për shoqërinë kosovare që nga paslufta e këndeje ka qenë dhe vazhdon të jetë niveli i madh i papunësisë që po mbretëron në Kosovë, dhe si pasojë e kësaj papunësie edhe probleme të tjera sociale siç është varfëria e cila është në rritje në kohën e fundit. Sipas disa hulumtimeve të bëra lidhur me papunësinë në Kosovë del që numri i papunësisë shënon shifra rekorde, jo vetëm në rajon por edhe me gjerë. Sipas disa të dhënave niveli i papunësisë në Kosovë sillet rreth 45-55 %.

Pra, përveç me nivele të larta të papunësisë periudha e tranzicionit në Kosovë karakterizohet edhe me shkallë të lartë të varfërisë. Sipas disa studimeve të bëra nga Banka Botërore, mese gjysma e popullatës së Kosovës është në nivelin e varfërisë apo edhe nën këtë nivel, kurse rreth 12 % e saj jeton në kushtet e varfërisë ekstreme (burimi: Banka Botërore).

Në Kosovë, përveç varfërisë dhe papunësisë së madhe problem tjetër praqet edhe reduktimi i vendeve të punës për shkak të ristrukturimit të vendeve të punës në sektorin publik. Reduktimet e vendeve të punës në ndërmarrjet publike në Kosovë janë përcjellë me pakënaqësi të shumta nga ana e punëtorëve duke reaguar më anë të grevave, protestave etj. Ndërsa sa i përket zhvillimit ekonomik në përgjithësi, mund të thuhet se Kosova në këtë aspekt është prapa jo vetëm në krahasim me shtetet e Evropiane, por edhe me vendet e rajonit. Kosova sikurse edhe vendet e tjera të rajonit ka filluar procesin e tranzicionit ekonomik, e cili nënkupton edhe procesin e privatizimit dhe krijimin e një ekonomie të tregut. Megjithëkëtë për dallim nga vendet e rajonit të cilat kanë filluar me herët procesin e privatizimit, në Kosovë ky proces ka filluar me vonesë dhe atë i përcjellë me probleme të shumta.

Prandaj, gjendja jo e mirë në këtë drejtim, tregon për rëndësinë që ka fenomeni i papunësisë dhe trajtimi i kësaj dukurie jo vetëm nga Institucionet qeveritare por edhe nga Shoqëria civile dhe me gjerë.

Në Kosovë, problemi i Papunësisë si i tillë ka goditur të gjitha kategoritë e shoqërisë pa dallim, por megjithëkëtë mund të thuhet se disa nga këto kategori të shoqërisë kosovare kanë qenë më të goditura nga kjo papunësi e madhe dhe dëmeve që ka sjellë ndryshimi i sistemit të punësimit në përgjithësi në Kosovë që nga viti 1990 e këndeje. Një ndër këto kategori të shoqërisë kosovare që ndoshta është duke i vuajtur në mënyrë të dyfishtë këto pasoja është Komuniteti Serb në Kosovë, si ata që jetojnë në Kosovë po ashtu edhe ata të cilët gjinden të zhvendosur në vende të tjera si pasojë e luftës së fundit në Kosovë. E themi këtë duke u nisur nga fakti se Komuniteti Serbë, ndonëse ka përberë vetëm 7-10 % të popullsisë në përgjithësi në Kosovë, ata (komuniteti serbë) kanë gëzuar dhe përjetuar privilegjet që ka ofruar sistemi i punësimit, por edhe sistemi në përgjithësi i cili ka dominuar deri në kohën e luftës se fundit në Kosovë, duke qenë

të privilegjuar në shumë fusha me rëndësi në Kosovë, jo vetëm në aspektin e punësimit por edhe në aspekte të tjera. Në anën tjetër, si pasojë e luftës dhe ndryshimit të sistemit të punësimit në përgjithësi në Kosovë, duke nënkuptuar këtu edhe procesin e privatizimit i cili është aktual në Kosovë. Komuniteti serbë, si në Serbi ku ndodhen si të zhvendosur nga lufta, po ashtu edhe ata në Kosovë, jo vetëm së kanë humbur këto privilegje të sipërpërmendura, por edhe po përballën me probleme të shumta në aspektin e punësimit dhe integritimit në jetën shoqërore në përgjithësi. Prandaj duke marrë parasysh këtë që u tha me sipër, hulumtimi i realizuar nga ne ka pas në fokus të vetin pikërisht problemin e papunësisë në komunitetin serbë në Kosovë, përkatësisht nxjerrjen e një analizë lidhur më papunësinë dhe menaxhimin e kësaj papunësie nga institucionet përkatëse dhe akterë të tjerë relevantë.

Në shumë sondazhe të realizuara me komunitetin serbë nga media dhe organizata të ndryshme, ka dalë si konstatim se një ndër problemet kryesore më të cilat ballafaqohet ky komunitet është problemi i papunësisë i cili bartë më vetë edhe probleme të tjera, si dhe lidhet ngushtë edhe me integritimin e personave të kthyer si dhe atyre të cilët jetojnë neper enklava të ndryshme në Kosovë, apo edhe atyre të cilët dëshirojnë të kthehen në Kosovë. Pra, gjendja e rëndë ekonomike në përgjithësi si dhe problemi i papunësisë në Kosovë, është përmendur si një nga faktorët kryesor që ka ndikuar për moskthimin dhe riintegrimin e të zhvendosurve serbë në Kosovë.

Megjithatë, hulumtimet e lartpërmendura kanë pasqyruar më tepër anën kuantitative të problemit të papunësisë duke mos u futur në një analizë kualitative të këtij problemi.

Kur flasim për rëndësinë e trajtimit të fenomenit të papunësisë në shoqërinë tonë, duhet ta kemi parasysh që shoqëritë moderne janë shoqëri të punës, të ndërtuara mbi bazën e etikës së punës dhe të aftësive profesionale, ndërsa vendet e punës përcaktojnë të ardhurat e njerëzve, ku përfshihen të ardhurat e transferuara, pozita e tyre shoqërore, dinjiteti dhe mënyra e organizimit të jetës. Sipas shumë sociologëve të njohur botëror, të jesh i papunë nuk është aspak e mirë ngase kjo shkatërron dinjitetin e njeriut, i prish rregullin e jetës dhe ve në varësinë e ndihmës për të papunët.

E gjithë kjo gjendje e rëndë si në aspektin ekonomik ashtu edhe në aspektet tjera e cila ekziston në Kosovë, mund të përshkruhet mase miri me konceptin e “anomisë”, për të cilin bënë fjalë sociologu i njohur Ralf Dahrendorf në veprën e tij “Konflikti shoqëror modern”. Koncepti i anomisë ka të bëjë me faktin së pakënaqësitë dhe konfliktet në shoqëritë e sotme moderne nuk shfaqen në formën e vijave të frontit në një betejë revolucionare, madje as si luftë demokratike e klasave, por si anomie. Koncepti i anomisë ka kuptimin e një gjendje që “sjellë pështjellim, dyshim dhe pasiguri për gjithçka”. Në shkencën shoqërore moderne ky koncept i atribuohet Emil Dyrkemit, i cili e përdorë anominë për të emërtuar ndërprerjen e efektshmërisë së normave shoqërore nga krizat politike, ose ekonomike. Pra anomia paraqet një gjendje ku bëjnë pjesë krimet e rënda, si krimet kundër pronës, dënduria e vrasjeve dhe vetëvrasjeve, grabitja me dhunë, shmangia nga detyrimet fiskale, apo format e tjera të krimit ekonomik etj.

Kjo që u tha më sipër tregon për rëndësinë që ka trajtimi dhe ndryshimi i qasjes ndaj problemit

të papunësisë në Kosovë. Ngase në një vend siç është Kosova me një status të pa definuar politik, papunësia e madhe që po mbretëron tek ne shumë lehtë mund të devijoj në ndonjë krizë sociale dhe si pasojë e kësaj mund të nxit jo vetëm trazira sociale por edhe politike. Për këtë arsye institucionet tona duhet ta ndryshojnë qasjen e tyre ndaj problemit të papunësisë në përgjithësi e ne veçanti ndaj problemit të papunësisë në komunitetin serbë. Kur themi në veçanti ndaj problemit të papunësisë në komunitetin serbë kemi parasysh ndjeshmërinë dhe lidhshmërinë që ka problemi i papunësisë me çështje të tjera siç është kthimi dhe integrimi i serbëve të kthyer dhe atyre që jetojnë në Kosovë. Me këtë veçim të komunitetit serbë nuk kemi pas për qëllim ti anashkalojmë edhe komunitetet tjera pakicë në Kosovë si dhe popullatën shumicë shqiptare, por me këtë kemi pasur parasysh ngjarjet të cilat kanë ndodhur në të kaluarën në mes të Komunitetit shqiptarë dhe atij serbë, ngjarje këto të cilat kanë krijuar një hendek të madh të mosbesimit në mes të këtyre dy komuniteteve.

Praktika e deritanishme në Kosovë dëshmon për lloje të ndryshme të diskriminimit sa i përket punësimit jo vetëm të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, por edhe punëkërkueseve në përgjithësi. Prandaj, ky hulumtim i yni ka për qëllim që të pasqyroj edhe këtë dukuri, pra të nxjerr rezultate nga terreni, për të parë së a ka apo nuk ka diskriminim etnik apo lloje të tjera të diskriminimit në aspektin e punësimit në Kosovë.

Po ashtu hulumtimi apo analiza ka për qëllim që të analizoj edhe shkaqet dhe faktorët e ndryshëm që kanë ndikuar që niveli i papunësisë në Kosovë të jetë i këtillë siç është.

Tregu i punës në Kosovë ka qenë një ndër pikat e identifikuar gjatë hulumtimit si një ndër faktorët e ndjeshëm i cili ka ndikuar që niveli i papunësisë të jetë e tillë siç është aktualisht. Po ashtu një problem tjetër që lidhet ngushtë me tregun e punës është edhe sistemi i arsimit në Kosovë i cili nuk është kompatibil me nevojat e tregut në Kosovë, si dhe mungesa e shkollimit profesional të mesëm.

Gjithashtu mungesa e një programi mbi punësimin sezonal është një ndër faktorët që ka ndikuar në mos zbutjen e papunësisë së madhe në Kosovë, po të ekzistonte një sistem apo mundësi e tillë edhe në Kosovë, atëherë kjo do të ndikonte në masë të madhe në zbutjen e papunësisë dhe rrjedhimisht edhe të varfërisë në Kosovë.

Në të gjitha programet që kanë të bëjnë me punësim duhet t'i jepet përparësi edhe komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë, e sidomos komunitetit serb i cili jeton në Kosovë duke pasur parasysh që kjo ndihmon integrimin me të mirë të tyre në jetën politiko-shoqërore të vendit.

2.2. Procesi i privatizimit- ndikimi në zbutjen e papunësisë

Në Kosovë deri më tani janë privatizuar një numër i konsiderueshëm i ndërmarrjeve publike, shumica prej të cilave kanë qenë jo funksionale për shkak të dëmtimeve gjatë luftës dhe dëmeve tjera që kanë pësuar gjatë dhjetë viteve të fundit. Edhe pse privatizimi i këtyre ndërmarrjeve është proklamuar se do të ndikoj në zbutjen e papunësisë në vend, kjo deri me tani megjithatë nuk po del të jetë e tillë, përkundrazi në shumë ndërmarrje të privatizuara janë larguar një numër i madh i punëtorëve të cilët kanë punuar aty për një kohë të gjatë. Prandaj procesi i privatizimit deri me tani nuk ka ndikuar pothuajse aspak në zbutjen e papunësisë në

vend, megjithëkëtë mbetet të shpresojmë që me privatizimin e ndërmarrjeve të mëdha të ndryshohet ky kurs dhe të përfitojnë të papunët.

Duke u bazuar në të dhënat e këtij hulumtimi, del që punësimi i komunitetit serb në ndërmarrjet e privatizuara dhe në sektorin privat është shumë e vogël, me përjashtim të rajonit të Gjilanit i cili qëndron me mirë në këtë drejtim. Prandaj nevojitet që të ndryshohet kjo qasje ndaj punësimit të komuniteteve në sektorin privat e sidomos në ndërmarrjet e privatizuara të cilat duhet ta kenë si kusht punësimin e një përqindje të caktuar të komuniteteve të ndryshme në këto ndërmarrje.

Ndërsa sa i përket punësimit të komunitetit serb në sektorin publik në Kosovë, duke u bazuar në të dhënat e grumbulluara nga terreni del që punësimi i komuniteteve pakicë në këtë sektor është me i mirë në krahasim me atë privat, kjo ndoshta nga fakti se punësimi në sektorin publik ka qenë i kushtëzuar nga institucionet ndërkombëtare në Kosovë. Siç është rasti p.sh me punësimin në Shërbimin Policor të Kosovës, Administratë Komunale, Trupat Mbrojtëse të Kosovës, dhe në disa institucione tjera publike. Edhe pse në sektorin publik gjendja rreth punësimit të komuniteteve pakicë është me e mirë, ka raste ku ka vende të zbrazura të punës për pjesëtarë të komunitetit serb, siç janë kuvendet komunale p.sh, por megjithëkëtë ato vende të punës akoma kanë mbetur të tilla. Prandaj, mund të konkludojmë së nevojitet një fushatë sensibilizuese lidhur me këtë, në mënyrë që këto vende të punës të cilat janë të rezervuara për komunitetin serb të plotësohen.

Po ashtu sa i përket sektorit publik në Kosovë dhe punësimit të komuniteteve në këtë sektor duhet të bëhet një sistemim me i mirë i vendeve të punës dhe hulumtimi i mundësisë për punësimin e komuniteteve pakicë në këtë sektor.

Gjatë këtij viti ka pasur një iniciativë nga ana e Qeverisë së Kosovës që të punësohet një numër i caktuar i komunitetit serb në kompanitë publike si në PTK dhe KEK, por kjo iniciativë siç duket nuk është realizuar deri në fund. Prandaj do të ishte mirë që kjo iniciativë të riaktualizohet dhe të kërkohet mundësia e punësimit të një numri me të madh të komuniteteve pakicë e sidomos të atij serb në këto kompani publike por edhe në kompani të tjera publike të cilat mund të punësojnë një numër të konsiderueshëm të punëtorëve po ta bëjnë një sistemim dhe ristrukturim me adekuat te vendeve të punës brenda kompanive të tyre.

Në vazhdim të raportit do t'i prezantojmë në mënyrë më të zgjeruar të dhënat e grumbulluara nga realizimi i hulumtimit të papunësisë tek komuniteti serb, ku në fund të këtij raporti do të dilet me disa rekomandime të bazuara në këto të dhëna të mbledhura gjatë realizimit të këtij projekti.

3. QËLLIMI

3.1. Qëllimi i raportit

Ky raport hulumtues bazohet në rezultatet kryesore të hulumtimit të arritura gjatë realizimit të projektit në përgjithësi. Qëllimi themelor i raportit është të paraqes këto të dhëna në mënyrë sa me objektive dhe reprezentative, duke marrë për bazë aspektin kuantitativ dhe sidomos atë kualitativ të këtyre rezultateve.

Prandaj, duke u bazuar edhe në qëllimi e vet projektit si të tillë, ky raport ka për qëllim:

Pasqyrimin e një analizë mbi gjendjen (shkaqet) e papunësisë së komunitetit serbë në Kosovë, rëndësinë që ka trajtimi i problemit të papunësisë si nga institucionet vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare të cilat veprojnë në Kosovë, kur dihet fakti se papunësia e madhe që po mbretëron në Kosovë mund të ngërthej pas vete edhe kriza të tjera sociale apo politike.

Si është bërë menaxhimi i kësaj papunësie nga institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare, cila ka qenë qasja ndaj këtij fenomeni dhe a duhet të ndryshohet kjo qasje e deritanishme.

Praktikat e mira dhe ato të këqija nga rajonet e ndryshme sa i përket menaxhimit të kësaj papunësie.

Pasqyrimi i llojeve të ndryshme të diskriminimit, ka pasur apo nuk ka pasur lloje të ndryshme të diskriminimit, duke përfshirë këtu edhe diskriminim në baza etnike.

Pasqyrimi i mundësive të ndryshme për punësim si dhe promovimi i këtyre mundësive në të gjitha instancat relevante, gjenerimi i vendeve të reja të punës si dhe mundësitë për kreditim dhe donacione për hapjen e bizneseve të vogla në vende të banuara nga komuniteti serb.

Dhe, qëllimi final i këtij raporti është nxjerrja e disa rekomandimeve të cilat do të bazohen në rezultatet e këtij raporti dhe të cilat do të shërbejnë si rekomandime orientuese për të gjitha institucionet dhe akterët tjerë të cilat janë të interesuar ta zbusin problemin e papunësisë në Kosovë, sidomos problemin e papunësisë tek komuniteti serbë në Kosovë.

4. MBLEDHJA E TË DHËNAVE-METODOLOGJIA

Mbledhja e të dhënave, përkatësisht metodologjia e përdorur në këtë raport ka qenë e kombinuar me një numër të caktuar metodash, ndër të cilat më të rëndësishme kanë qenë metoda kualitative dhe ajo kuantitative.

Përveç këtyre metodave hulumtuese të lartcekura, janë përdorur edhe metoda tjera hulumtuese të cilat kanë ndihmuar në mbledhjen e të dhënave.

Ndërsa teknikat apo instrumentet e përdorur kanë qenë, diktafoni për incizimin e të dhënave të cilat më pas janë transkriptuar, si dhe Foto-Aparati Digjital me të cilin janë marrë pamje nga takimet.

Mostra është bërë në atë mënyrë që ajo të përfshinë rajonet kryesore të Kosovës, duke u bazuar edhe në mundësitë e kufizuara të projektit. Për këtë arsye kjo mostër ka qenë e kufizuar dhe hulumtimi është realizuar vetëm në 6 qendrat apo rajonet kryesore të Kosovës, si në :

- Prishtinë;
- Gjilan;
- Mitrovicë;
- Pejë;
- Ferizaj dhe
- Prizren.

Në të gjitha këto rajone janë zhvilluar një numër i madh i intervistave kualitative individuale me zyrtar të ndryshme, janë intervistuar zyrtar nga zyrat për komunitete në rajonet e sipërpërmendura. Gjithashtu janë zhvilluar intervista edhe me përfaqësues të zyrave rajonale për punësim dhe të zyrës qendrore në Prishtinë.

Është bërë një analizë studimore dhe krahasimtare e materialeve dhe dokumenteve të ndryshme lidhur me papunësinë të cilat janë nxjerr nga zyra qendrore në Prishtinë si dhe zyrat rajonale për punësim, si dhe janë marrë për bazë edhe statistika të ndryshme nga hulumtime të realizuara me herët lidhur me papunësinë në Kosovë.

Të gjitha intervistat e realizuar janë bazuar në një draft udhëzues për intervistim i cili është përgatitur enkas për realizimin e këtyre intervistave kualitative. Ky draft udhëzues për intervistim ka përfshirë pikat kryesore të cilat është dashur të merren si orientim për realizimin e intervistave në terren.

Ky hulumtim është realizuar në terren. Ndërsa realizimi i këtij hulumtimi është bërë nga ekipi për hulumtime i cili vepron në kuadër të OJQ-së “Mileniumi i Ri”.



5. PREZANTIMI I REZULTATEVE

Jo vetëm procesi i transicionit por edhe ngjarjet e vitit 1999 në Kosovë kanë sjell një gjendje të veçantë të çështjes së papunësisë, që këtë vend e dallon nga vendet tjera në transicion. Me këtë nënkuptohet edhe vetë menaxhimi i papunësisë, që është një proces i veçantë dhe tepër kompleks.

Në rajone të ndryshme të Kosovës, sipas vlerësimeve nga ky projekt, problemi i papunësisë, ose thënë më shkoqitur, menaxhimi i papunësisë sa i përket pjesëtarëve të komunitetit serbë është i ndryshëm dhe variron varësisht nga specifikat shoqërore, ekonomike e gjeografike të rajoneve.

Në shumë rajone dhe komuna të Kosovës bashkëpunimi mes Qendrave Rajonale për Punësime në një anë dhe komunave të Kosovës e pjesëtarëve të komunitetit serbë në anën tjetër nuk është në nivelin e kënaqshme të bashkëpunimit, i cili do të mund të reflektonte me një menaxhim më të mirë të papunësisë.

Ndërsa sa i përket mundësisë të bashkëpunimit me sektorin privat të biznesit, edhe ky është mjaft i ultë, derisa nuk përjashtohet mundësia në të ardhmen që me avansimin këtij sektor të zvogëlohet edhe numri i të papunëve sidomos tek pjesëtarët e komunitetit serbë.

Njëri ndër problemet tjera sa i përket menaxhimit të papunësisë është edhe moskualifikimi i duhur i atyre që aktualisht gjenden në listat e punëkërkuësve. Andaj disa Qendra Rajonale për Punësim kanë ndërmarrë aksione për të kualifikuar përmes kurseve të ndryshme punëkërkuësve në mënyrë që sa më lehtë të gjenden afër tregut të punës.

5.1. Regjioni i Gjilanit

Në bazë të rezultateve të mbledhura në institucionet relevante në regjionin e Gjilanit lidhur me çështjen e papunësisë së pjesëtarëve të komunitetit serbë, të regjistruar në Qendrën Rajonale të Punësimit punë kërkojnë 3605 pjesëtarë të komunitetit serbë dhe 112 pjesëtarë të komuniteteve tjera joshqiptare përballë 34146 pjesëtarëve të komunitetit shqiptarë që janë të evidencuar si punëkërkues.

Pavarësisht këtyre shifrave, praktikisht në Qendrën Rajonale për Punësim, është dhënë shembull i punësimit të pjesëtarëve të komunitetit serb ku janë të punësuar katër (4) pjesëtarë të komunitetit serbë, prej tyre tre (3) janë këshilltarë për punësim dhe një punëtor nga komuniteti serbë punon si punëtor administrativ. Ndërsa me qëllim që shërbimi i punësimit të jetë sa më afër këtij komuniteti është mundësuar hapja e tri (3) nën-zyrave të punësimit në tri (3) fshatra me shumicë serbe ku punëkërkuesit e këtij komuniteti paraqesin nevojat dhe kërkesat e tyre në lidhje me punësimin.

Siç dihet numri i përgjithshëm i punëkërkuesve në rajonin e Gjilanit (Gjilan, Viti, Kamenicë) është 34146, nga këta minoriteti serb i takojnë 3605, ndërsa minoriteteve tjera gjithsej 1112. Papunësia si një dukuri shumë e theksuar ndikon negativisht dhe shkakton probleme të shumta të gjithë punëkërkuesit pa dallim etnie e rrjedhimisht edhe komuniteti serb.

Niveli i shkallës shumë të ultë të zhvillimit ekonomik është vlerësuar si determinuesi kryesor që numri i punëkërkuesve (jo vetëm nga ata) nga pjesëtarët e komunitetit serbë është kaq i madh ndërsa në anën tjetër nuk ka diskriminim në baza etnike sa i përket çështjes së punësimit. Tashmë dihet se edhe shkaqet e papunësisë në regjionin e Gjilanit për të gjithë punëkërkuesit e natyrisht edhe për punëkërkuesit nga radhët e pjesëtarëve të komunitetit serbë janë si rezultat i shkallës së ulët të zhvillimit ekonomik që aktualisht mbizotëron në këtë regjion. Nga ajo që është performuar deri më tani nuk ka pasur asnjë diskriminim në baza etnike sa i përket punësimit të komuniteteve të ndryshme që jetojnë në këtë regjion. Kjo lidhet edhe me faktin se Qendra Rajonale për Punësim si institucion nuk hap vende të reja të punës por kjo çështje varet krejtësisht nga tregu i punës sesa vende të punës tregu ofron në Qendrën Rajonale të Punësimit.

Ndërsa në anën tjetër struktura e punëkërkuesve është e përbërë nga të gjitha kategoritë e mundshme. Megjithatë mbizotëron mosha e re duke pasur parasysh që vendi është me një popullsi shumë të re krahasuar me vendet e tjera, sa i përket strukturës vërehet se ka pak më tepër punëkërkues nga radhët e gjinisë mashkullore krahasuar me femrat, si dhe e atyre të pakualifikuarve (pra që janë më shumë me shkollë të mesme madje ka edhe me shkollë fillore e deri tek ata që nuk e kanë të përfunduar as shkollën fillore).

Edhe ato pak vende që janë ofruar për pjesëtarët e komunitet serb janë plotësuar në shkallën 100 për qind. Rezultatet e hulumtimeve në lidhje me këtë pikë në çështjen e punësimit të pjesëtarëve të komunitetit serb thonë se nuk ka ndodhur deri me tani që nga shërbimet që

ofron kjo qendër që të ofrohet ndonjë vend për pjesëtarët e komunitetit serbë e i cili vend i lirë pune nuk është plotësuar. Pra në këtë aspekt kjo Qendër është treguar shumë e sinqertë në menaxhimin e saj dhe madje edhe transparente edhe sa i përket kësaj çështje që ka ndërlidhje me pjesëtarët e komunitetit serbë.

Në lidhje me zbutjen e papunësisë tek pjesëtarët e komunitet serb kanë ndikuar edhe trajnimet dhe aftësimet e veçanta nga institucione e organizata të ndryshme. Në këtë drejtim do të vlente të përmendim në këtë raport ndihma që i është mundësuar Qendrës Rajonale për Punësim në Gjilan nga ana e IOM-it që në kuadër të qendrës së aftësimeve profesionale të hapet një kabinet me të gjitha pajisjet përcjellëse për aftësimin e komunitetit serb në lëmin e të të mësuarit të kompjuterit, si dhe në lëmin e të gjitha drejtimeve të tjera që ofron kjo qendër profesionale. Megjithëkëtë hulumtimet tregojnë se edhe përkundër njoftimeve me kohë që ju janë bërë punëkërkesve të pjesëtarëve të komunitetit serbë që ta shfrytëzojnë këtë shërbim që i'u është ofruar ata kanë hezituuar në masën më të madhe për t'u inkuadruar në këto aftësime të veçanta në mënyrë që shifrat e papunësisë tek pjesëtarët e komunitet serbë të pësojnë rënie. Edhe hulumtimet e ekipit të këtij projekti por edhe shënimet nga Qendra Rajonale për Punësim në Gjilan, arsyet e hezitimit të pjesëtarëve të komunitet serbë që të kyçen në këto aftësime profesionale të ofruara nga organizata ndërkombëtare IOM nuk kanë mundur të identifikohen.

Në anën tjetër në kuadër të ngritjes së bashkëpunimit të të gjitha institucioneve dhe organizatave relevante në mënyrë që papunësia tek radhët e pjesëtarëve të komunitetit serbë të zvogëlohet, në këtë drejtim ka pasur ngecje. Sidomos mes Qendrës Rajonale për Punësim dhe Kuvendit Komunal të Gjilanit. Sipas të dhënave hezitimi në këtë drejtim ka ardhur si pasojë e neglizhencës së Kuvendit Komunal meqë arsyetimet e tyre janë vlerësuar se Qendra Rajonale për Punësim në Gjilan është e emëruar dhe i përgjigjet në mënyrë institucionale Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale. Kemi vlerësuar se kjo pjesë do të duhej të bëhet pjesë e këtij raporti me faktin se ky moskoordinim në një formë a tjetër ka mundur të ndikoj që institucionet tona të mos tregohen të përgjegjshme se zbutja e papunësisë tek qytetarët e tyre, pavarësisht cilit komunitet i takojnë, nuk mund të bëhet përmes formave të bojkotit a injorimit të institucioneve të veçanta. Ndërsa nga ana e autoriteteve lokale të komunës së Gjilanit ka rrjedhur vlerësimi se Qendra Rajonale për Punësim nuk ka shënuar ndonjë rezultat që do të vlente të cekej në fushën e zbutjes së papunësisë tek pjesëtarët e komunitetit serbë. Përkundër faktit se zhvillimi i tashëm ekonomik është në nivel të ultë aq sa edhe suksesi i procesit të privatizimit, si dy akterët kryesore që kanë mundur të ndikojnë në zbutjen e papunësisë tek radhët e pjesëtarëve të komunitetit serbë, ashtu edhe procesi i definimit të statusit të Kosovës varet nga kujdesi institucional ndaj pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë që jetojnë në Kosovë është me rëndësi. Andaj përgjegjshmëria është tepër e madhe e institucioneve që nuk bashkëpunojnë mes tyre në këtë drejtim.

Ndërsa në kuadër të shënimit të progresit në fushën e uljes së shifrave të papunësisë tek pjesëtarët e komunitet serbë si pasojë e bashkëpunimit me institucioneve relevante në këtë drejtim, bashkëpunimi mes Qendrës Rajonale për Punësim në Gjilan dhe Ndërmarrjeve Publike dhe Ndërmarrjet Private duket në shikim nga jashtë se është mjaft i mirë. Andaj, krejtësisht si

pasojë e këtij bashkëpunimi shumica (pavarësisht numrave që nuk i disponojnë pothuaj askush ose së paku nuk i bëjnë publike) e të punësuarve nga radhët e pjesëtarëve të komunitetit serbë është bërë kryesisht në Ndërmarrjet Publike dhe Ndërmarrje Private në këtë region të Kosovës. Kjo ka rrjedhur deri në një shkallë të mjaftueshme duke ditur edhe problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen aktualisht shumica e Ndërmarrjeve Publike dhe Private. Veçanërisht vlen të ceket se asnjë hezitim deri më tani nuk ka ndodhur nga asnjë Ndërmarrje Private për të punësuar pjesëtarët e komunitetit serbë të cilat kanë pasur kualifikimet që i ka kërkuar vendi i punës i shpallur edhe pse numrat mungojnë....

Në lidhje me çështjen e mundësive të zbutjes së papunësisë tek radhët e pjesëtarëve të komunitetit serbë vlen të cekën shifrat se vetëm në komunën e Gjilanit jetojnë afër 14.500 pjesëtarë të komunitetit serbë, ku nga ky numër rreth 8.000 janë të aftë për punë por nga ta punojnë vetëm 515 pjesëtarë të këtij komuniteti. Edhe pse ky numër është mjaft i vogël, vlen të ceket se shumica e këtyre të punësuarve nga radhët e pjesëtarëve të komunitetit serbë janë të angazhuar në Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK), pastaj në sistemin e arsimit, sistemin e shëndetësisë dhe një numër i tyre është i punësuar si pjesëtarë të shërbimit civil në kuadër të administratës komunale të Gjilanit në resor të ndryshëm të saj. Edhe pse në administratën civile në Kuvendin Komunal të Kosovës akoma ka vende të zbraztë dhe të rezervuara për pjesëtarët e komunitetit serbë. Arsyet për këto vende që ende nuk janë plotësuar me pjesëtarë të komunitetit serbë janë se nuk janë shpallur konkurset ende ose njëra ndër arsyet tjera është se janë të plotësuar përkohësisht me pjesëtarë të komuniteteve tjera dhe tashmë çështja në këtë drejtim është çështje kohe e sistemit të tyre ose gjetjes së ndonjë zgjidhje në mënyrë që të hapet rruga që në ato vende ku janë të rezervuara për pjesëtarët e komunitetit serbë të plotësohen.

5.2. Rajoni i Ferizajt

Në komunën e Ferizajt shifrat flasin se jetojnë 4.300 pjesëtarë të komuniteteve të ndryshme ku nga ky numër 3.300 janë pjesëtarë të komunitetit ashkalinjë, 265 pjesëtarë të komunitetit romë, 260 pjesëtarë të komunitetit goranoboshnjak, 145 pjesëtarë të komunitetit serbë, 30 pjesëtarë të komunitetit turk dhe pjesa përbëjnë pjesëtarët e komuniteteve tjera. Nga këto shifra numri i përgjithshëm i punëkërkueseve nga radhët e komuniteteve joshqiptare është mbi 2000 pjesëtarë.

Vlerësimet që vijnë nga anë të ndryshme të institucioneve relevante në komunën e Ferizajt tregojnë bindshëm se të mos ketë pasur diskriminim në baza etnike sa i përket punësimit të minoriteteve. Të paktën deri më tani kjo nuk ka ndodhur dhe nuk ka asnjë shënim për ndonjë rast që do të tregonte diskriminim në këtë drejtim. Ndërsa sa ju përket pjesëtarëve nga radhët e komuniteteve joshqiptare në shumicën e rasteve të punëkërkueseve atyre iu mungon edukimi i mjaftueshëm apo kualifikimi i duhur për vende të caktuara të punës.

Shënimet flasin se përkundër problemit që është mjaft i theksuar në menaxhimin e papunësisë tek pjesëtarët e komuniteteve të ndryshme në komunën e Ferizajt të punësuar deri më tani në bazë të shifrave zyrtare janë gjithsej 99 pjesëtarë nga radhët e komuniteteve joshqiptare si 90 pjesëtarë të komunitetit ashkalinjë, 4 goranoboshnjak, 4 rom dhe një serb. Të gjithë këta të punësuar janë të kyçur në sektorin publik, derisa në sektorin privat janë 82 familje të pjesëtarëve të komuniteteve joshqiptare që merren me veprimtari të ndryshme kryesisht zanatlinj që në këtë rast kemi vetëpunësim që shënon një rast të veçantë për komunën e Ferizajt për dalim nga shumica e komunave dhe regjioneve tjera të Kosovës.

Në anën tjetër organet komunale kanë një bashkëpunim shumë të mirë me Qendrën Rajonale të Punësimit në Ferizaj ku kjo manifestohet me takime të rregullta javore edhe pse deri më tani në masën më të madhe kanë munguar rezultatet konkrete që pjesëtarët e komuniteteve joshqiptare, në veçanti ata të komunitetit serbë të punësohen përmes Qendrës Rajonale për Punësim në këtë komunë. Kjo ndoshta edhe për arsye të specifikave të tregut të punës në këtë regjion.

Vlen po ashtu të ceket se kohë më parë një ndërmarrje private kishte shpallur një konkurs dhe kishte planifikuar punësimin e një numri të caktuar të pjesëtarëve nga radhët e komuniteteve, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur për arsye që nuk janë të njohura publikisht. Burime tjera thonë se nuk ka pasur interesim nga radhët e pjesëtarëve të komuniteteve joshqiptare. Në këtë drejtim Kuvendi Komunal i Ferizajt ka edhe Zyrën për Komunitete në fshatin Bablak, i banuar me pjesëtarë të komunitetit serbë, por vlerësimet janë se qytetarët e këtij lokaliteti nuk iu përgjigjen ftesave për aplikim dhe pjesëmarrje në konkurse të shpallura nga organet komunale të Ferizajt.

Ndërsa përmes Qendrës për Aftësime Profesionale, në komunën e Ferizajt janë ndihmuar pjesëtarët e komuniteteve në kryerjen e disa kurseve të ndryshme për aftësime të veçantë në mënyrë që më lehtë të vihet deri tek punësimi i tyre. Kjo kryesisht ka ndodhur edhe me Zyrën për Komunitete dhe OSBE-në ku janë certifikuar 12 pjesëtarë të komunitetit ashkalinjë dhe 4 nga radhët e komunitetit romë, ndërsa asnjë pjesëtarë nga radhët e komunitetit serbë nuk i është përgjigjur ftesave të tilla për aftësime profesionale në mënyrë që të punësohen më lehtë në vende të ndryshme.

Në këtë drejtim, të menaxhimit të papunësisë tek pjesëtarët e komunitetit serbë në veçanti, ka ndihmuar edhe një projekt i mbështetur nga UNDP-ja. Fillimisht është menduar se do të mund të punësohen rreth 50 pjesëtarë duke përfshirë pjesëtarët e të gjitha komuniteteve joshqiptare, por më vonë ky numër u reduktua në vetëm 12 persona.

5.3. Rajoni i Prizrenit

Menaxhimi i papunësisë në komunën e Prizrenit vlerësohet se është një sfidë e veçantë në përmbajtje ndërsa një sfidë e vështirë në përmbajtje. Shënimet dhe analizat flasin për shifra të papërputhshme edhe në raportin e një diskriminimi pozitiv që po aplikohet në Kosovë në favor të pjesëtarëve të komuniteteve joshqiptare, në veçanti asaj serbe.

Kështu, numri i përgjithshëm i të papunëve (i punëkërkuesve) në Rajonin e Prizrenit në fund të muajit prill është vlerësuar në shifrën prej 52.473 nga të cilët sipas përkatësisë etnike ishin 45.213 pjesëtarë të komunitetit shqiptarë, 4.341 pjesëtarë të komunitetit boshnjakë, 1.094 pjesëtarë të komunitetit turk, 665 pjesëtarë të komunitetit ashkalinjë, 933 pjesëtarë të komunitetit romë, 176 pjesëtarë të komunitetit serb, 1 pjesëtar i komunitetit malazez dhe të tjerë 50 të cilat nuk e kanë të qartësuar identitetin dhe nuk janë deklaruar se cilit komunitet i përkasin.

Në anën tjetër është e rëndësishme kualifikimi të papunëve meqë nga kjo shkallë vlerësohen edhe mundësia e aftësisë të tyre në mënyrë që arritja deri te punësimi i tyre të përshkojë një rrugë sa më të shkurtër që të jetë e mundur. Kështu në këtë rajon, numri i të papunëve sipas kualifikimit vlerësohet se 39.399 janë të pakualifikuar, pastaj gjysmë të kualifikuar janë 1.006, të kualifikuar (me shkollë të mesme profesionale) 3.382 dhe me shkollë të lartë dhe me fakultet të përfunduar janë 217 punëkërkues. Ndërsa për dallim nga shumica e regjioneve tjera në Prizren nga ky numër i punëkërkuesve 52,2 % janë të gjinisë femërore ose 26.563 punëkërkuese.

Në kontekst të menaxhimit të papunësisë në këtë regjion, bashkëpunimi mes institucioneve relevante në këtë drejtim vlerësohet se është i mirë edhe pse nuk shihet ndonjë rezultat konkret që do të tregonte një performancë më të mirë në zvogëlimin e mundshëm të numrit të të papunëve sidomos tek pjesëtarët e komunitetit serbë. Vlerësimet në kuadër të këtij bashkëpunimi mes institucioneve që merren me këtë problematikë kryesisht shkojnë në shkëmbimin e informacioneve... Në këtë drejtim bashkëpunimi ka rrjedhur mes Organizatave Joqeveritare lokale (një numër sish nga to), me Odën Ekonomike – Dega në Prizren dhe me përfaqësuesit e bizneseve private. Ndërsa vlerësohet se tërësisht ka munguar bashkëpunimi i mirë me sektorin e ekonomisë publike si njëri ndër sektorët që në kushte dhe rrethana tjera do të duhej të ishte determinuesi kryesor në zvogëlimin e shifrave të të papunëve.

Edhe në regjionin e Prizrenit ekziston Qendra Rajonale për Aftësi Profesionale (QRAP) ku ofrohen aftësi të ndryshme për të papunët. Ndër kurset që ofrohen për aftësi të të papunëve janë kurset si hidraulik-automatik, kuzhinier, kamerier, riparim i teknikes së bardhë, biznes, saldim, autoelektrikë etj. Shumëllojshmëria e aftësimeve të ndryshme që ofrohen nga kjo Qendër në këtë Regjion lë për të shpresuar se menaxhimi i papunësisë këtu është më afër realitetit megjithëse ende nuk ka progres në këtë fushë ashtu sic janë caktuar objektivat e tyre.

Mirëpo, menaxhimi i papunësisë në Regjionin e Prizrenit tek pjesëtarët e komunitetit serb është pothuaj në shkallët kritike meqë bashkëpunimi i tyre me institucionet relevante që punojnë për të zvogëluar numrin e të papunëve tek rradhët e pjesëtarëve të komunitetit serbë nuk është as për së afërmi i kënaqshëm. Për dallim nga pjesëtarët e komunitetit serbë, në këtë drejtim bashkëpunimi i pjesëtarëve të komuniteteve tjera është në nivel të duhur me institucionet relevante që për qëllim kanë punësimin e të papunëve.

Ndërsa për sa i përket karakteristikave të tregut në këtë rajon njerëzit kryesisht merren me tregti, hotelieri, zejтари, zdrukthëtari e të tilla të ngjashme. Ndërsa aktivitetet industriale praktikisht nuk ekzistojnë në këtë komunë pas lufte për rrethana tashmë të njohura. Po ashtu as procesi i privatizimit në këtë mes nuk ka dhënë asnjë rezultat që do të mund të ngrite nivelin e menaxhimit të papunësisë. Edhe pse ky proces synon edhe punësimin e të papunëve praktikisht është duke ndodhur e kundërta flasin vlerësimet e shumanshme në këtë rajon.

5.4. Rajoni i Mitrovicës

Sipas shënimeve të Qendrës Rajonale për Punësim në Mitrovicë, numri i punëkërkuësve në rajonin e Mitrovicës që përfshin komunat Mitrovicë, Skenderaj, Vushtrri, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq është 63.039 ku nga ky numër 29.840 janë pjesëtarë të komunitetit serbë.

Regjioni i i komunës së Mitrovicës ka specifikat e njohura tashmë jo vetëm ato politike por edhe ato ekonomike që mund të ndërlidhen me mënyrën se si menaxhohet papunësia, në veçanti, tek radhët e pjesëtarëve të komunitetit serbë. Në këtë komunë, edhe në këtë lëmi, ekzistojnë dy zyra të komuniteteve që merren edhe me çështjen e punësimit të pjesëtarëve të komunitetit serbë si shumicë e komuniteteve joshqiptare. Bashkëpunimi i këtyre dy zyrave të komuniteteve në lidhje me punësimin e mundshëm bëhet ekskluzivisht përmes përfaqësuesve të KFOR-it.

Tashmë dihet se në këtë komunë jetojnë përafërsisht rreth 25.000 pjesëtarë të komunitetit serb dhe këta pothuajse të gjithë në pjesën që njihet si pjesa veriore e Mitrovicës. Po ashtu në komunën e Mitrovicës, e cila komunë edhe njihet si njëra ndër komunat me përzierje më të madhe etnike jetojnë edhe afro 2.500 pjesëtarë të komunitetit boshnjak, rreth 2.500 pjesëtarë nga komunitetit turk dhe afër 500 pjesëtarë të komunitetit ashkalinjë dhe rreth 700 pjesëtarë të komunitetit romë.

Shifrat për numrin e saktë të pjesëtarëve të komuniteteve joshqiptare që kërkojnë punë janë jorelative. Megjithëkëtë numri i të papunëve në komunën e Mitrovicës është shumë i madh, konkretisht sa ju përket komuniteteve joshqiptare numri i tyre sillet rreth 90%. Ndërkaq sa i përket pjesëtarëve të komunitet serbë vlerësimet thonë se ata qëndrojnë shumë më mirë se sa pjesëtarët e komuniteteve tjera me faktin se shumica prej tyre marrin ndihma dhe benificione të ndryshme nga shteti i Serbisë si dhe po ashtu edhe nga organizatat e huaja ndërkombëtare po ashtu për shkaqe të cilat tashmë janë të njohura për opinionin e gjerë.

Kjo mund të ilustruhet edhe me faktin se i njëjti zyrtar që punon pozitën e njëjtë në pjesën veriore të qytetit me atë të pjesës jugore në organet komunale dallon në të ardhura të përgjithshme. Zyrtarët komunalë në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës, të cilët janë pjesëtarë të komunitetit serbë marrin nga dy paga, një nga buxheti i Kosovës dhe një nga ai i Serbisë që paraqet një formë të veçantë të mënyrës së menaxhimit jo vetëm të papunësisë në radhët e pjesëtarëve të komunitetit serbë. Ndërsa edhe ata që nuk punojnë marrin ndihma të ndryshme si psh. nga 40 euro ndihma në formë të pagës i marrin nga buxheti i Kosovës dhe nga 50 euro nga Serbia duke ua shtuar këtu edhe benificionet dhe ndihmat e ndryshme nga organizata e huaja ndërkombëtare.

Në Kuvendin Komunal të Mitrovicës vlerësohet se nga buxheti i përgjithshëm komunal, vetëm për komunitetet ndahen 14,3 për qind e buxhetit. Kjo bëhet me qëllim sa të afrimit të kushteve sa më të mira ashtu edhe për mundësinë e menaxhimit të papunësisë dhe zbutjes së rasteve

sociale për të krijuar një ambient sa multetnik ashtu edhe prosperuese në këtë komunë.

Në anën tjetër në sferën e menaxhimit të papunësisë vlerësohet se nuk ka asnjë rast që do të mund të evidentohet si diskriminim mbi baza etnike sa i përket punësimit. Mirëpo këtu evidentohet një fenomen tjetër. Tentimi për t'u keqpërdorur konkurset për punë që janë të destinuara ekskluzivisht për pjesëtarë të komuniteteve joshqiptare. Andaj, pjesëtarë të komunitetit shqiptar kanë tentuar që përmes organeve relevante të regjistrohen si pjesëtarë të komuniteteve tjera me qëllim që të vihet me lehtë deri tek punësimi meqë ato konkurse ishin të destinuara për komunitetet pakica. Andaj jo ndonjë diskriminim i llojit të vetë mirëpo tentime për keqpërdorime në këtë drejtim ka pasur tentime, derisa vlerësohet se nuk dihet saktësisht se a ka pasur sukses ndonjë tentim i tillë. Nëse kjo vërtetohet atëherë mund të konkludohet në këtë aspekt se menaxhimi i papunësisë nga radhët e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë ka dështuar në këtë segment.

Mirëpo faktorë relevant që merren me çështjen e papunësisë në këtë regjion ritheksojnë disa herë se pjesëtarët e komunitetit serbë jetojnë me një standard më të lartë krahasuar me pjesëtarët e komuniteteve tjera në këtë regjion, që lë për të konstatuar se menaxhimi i papunësisë tek ky komunitet ka pasur mundësi të sjell diskriminim në aspektin tjetër në rastet kur vendet e punës nuk kanë qenë të destinuara ekskluzivisht për pjesëtarët e komunitetit serbë.

Edhe në këtë rajon është konstatuar se shkalla e lartë e numrit të të papunëve do të mund të zvogëlohej nëse do të kemi një privatizim të mirëfilltë. Vlen të ceket në këtë mes se dikur në kombinatin "Trepça" në Mitrovicë ishin të punësuar rreth 25 mijë qytetarë të kësaj ane.

Në Qendrën Rajonale për Aftësi Profesionale në Mitrovicë ipen kurset e ndryshme ku aktualisht ato i ndjek mi 100 pjesëtarë të komuniteteve të ndryshme, në përjashtim të pjesëtarëve të komunitetit serbë. Zyrtarisht nuk dihet se pse pjesëtarët e komunitetit serbë, edhe pse kanë nevojë për aftësi profesionale për të ardhur më lehtë deri tek punësimi, refuzojnë bashkëpunimin me këtë Qendër. Ky institucion në Mitrovicë disponon me shtatë profesione të ndryshme si ai për kuzhinë, tekstil, ndërtimtari, zdrukthëtari, metal, kompjuterizëm dhe administrim biznesi. Në këto kurse përgatiten kuadrot konform nevojave të tregut të punës.

Mundësia e punësimit të pjesëtarëve të komunitetit serbë në sektorin e biznesit vlerësohet se është mjaft i vështirë me faktin se ky sektor kryesisht i pranon njerëzit e vetë në punë, pra nga rrethi familjar . Ndërkaq vlerësimet në Rajonin e Mitrovicës për mundësitë e punësimit në ndërmarrjet publike janë se njerëzisht kryesisht pranohen në punë sipas përkatësisë (orientimit) partiak edhe pse kohëve të fundit është zvogëluar në mënyrë drastike trendi i punësimit në këto ndërmarrje.

Rajonin e Mitrovicës e karakterizon edhe situata politike, ku për shkak të kësaj është eliminuar përkohësisht në masë të madhe edhe mundësia që përmes investitorëve të jashtëm gjatë krijimit të bizneseve të reja investuese të punësohen pjesëtarët e komunitetit serbë në veçanti. Kjo ikje në investime bëhet kryesisht për shkak të pasigurisë së tyre për kapitalin e tyre.

Në drejtim të gjetjes së alternativave që të menaxhohet papunësia sa më mirë, institucionet komunale dhe ato që merren ekskluzivisht me çështjen e papunësisë në rajonin e Mitrovicës është mjaft i mirë siç është vlerësuar nga këta akterë. Ky bashkëpunim vlerësohet se aktualisht është në shkëmbimin e informacioneve gjenerale dhe informacioneve të veçanta si për vende të lira pune në anë të ndryshme.



5.5. Rajoni i Pejës

Edhe në rajonin e Pejës menaxhimin e papunësisë tek radhët e komunitetit serbë dhe jo vetëm tek ky e paraqet moskualifikimi dhe/apo mosarsimimi i tyre.

Në anën tjetër sa i përket çështjes së diskriminimit në segmentin e menaxhimit të papunësisë tek pjesëtarët e komunitetit serbë, konstatimet shpijnë në atë se jo që ata nuk kanë ndonjë lloj të diskriminimit por vetë janë pjesë e diskriminimit pozitiv sepse atyre u ipet përparësi në shumë drejtime. Vlen këtu të ceket se ky term tashmë të njohur në Kosovë, ka filluar të përdoret kryesisht për pjesëtarët e komunitetit serbë sidomos nga fillimi i implementimit të standardeve për Kosovën.

Mirëpo, sa u përket pjesëtarëve të komunitetit serbë, pengesë jo vetëm në menaxhimin e papunësisë nga radhët e tyre na paraqitet edhe problemi me bojkotin nga ana e tyre për t'u integruar në jetën shoqërore e politike të këtij rajoni. Vlerësimet komunale janë se përveç pjesëtarëve të komunitetit serbë, të gjitha komunitetet tjera janë të integruar në të gjitha rrjedhat e jetës politike, shoqërore, ekonomike, kulturore e sportive etj.

Andaj si pasojë e mosintegritimit në jetën shoqërore të këtij rajoni dhe të mos bashkëpunimit nga ana e pjesëtarëve të komunitetit serbë edhe kjo pjesë e raportit do të mbetet më e varfër. Në fshatin Gorazhdec funksionon një zyrë e veçantë e pjesëtarëve të komunitetit serbë dhe e cila i ka të gjitha të dhënat, analizat dhe çështjet tjera sa i përket çështjes së papunësisë dhe menaxhimit të saj, por që edhe kësaj radhe ata refuzojnë bashkëpunimin.

5.6. Rajoni i Prishtinës

Sipas shënimeve të Qendrës Rajonale për Punësim në Prishtinë, numri i përgjithshëm i punëkërkuesve në këtë rajon është 65946, prej tyre 60903 shqiptarë, 2449 serb, 62 boshnjak, 25 turq, 8 malazez, 1632 ashkalinjë, 846 rom, dhe të tjerë 21. Kjo do të thotë se menaxhimi i papunësisë në këtë rajon paraqet sfidë në vete duke marrë parasysh sa numrin e madh të punëkërkuesve ashtu edhe zhvillimin ekonomik të këtij rajoni dhe specifikat tjera.

Në këtë drejtim, menaxhimi i papunësisë ndërlihet vetvetiu edhe me bashkëpunimin që kanë akterët relevant të kësaj problematike të shoqërisë sonë. Vlerësimet e para janë se sa i përket bashkëpunimit me komunat e këtij rajoni, kryesisht me Qendrën Rajonale për Punësim, ai është relativisht i mirë. Ky bashkëpunim kryesisht rrjedh nga komunikimi i rregullt i raportet periodike dhe mujore për komunat. Ndërsa parçialisht ky bashkëpunim është posaçërisht i mirë dhe i drejtuar direkt me drejtoratet e caktuara të Kuvendeve Komunale si me Drejtoratet për Ekonomi dhe Zhvillim, me Drejtoratet për Qeverisjen e tokës ndërtimore, me Drejtoratet e Transportit etj. Në anën tjetër bashkëpunimi me biznese të ndryshme dhe Qendrës Rajonale për Punësim zhvillohen në baza të kontakteve ditore përmes këshilltarëve të cilët e mbulojnë tërë territorin e rajonit.

Vlen të potencohet se në kuadër të mundësive për një menaxhim të mirë të papunësisë sidomos tek pjesëtarët e komunitetit serbë, Qendra Rajonale për Punësim në Prishtinë bashkëpunon me UNDP-në dhe ILO-në ku janë të nënshkruara Memorandumet e Mirëkuptimit sipas të cilit që të dy këto institucione përmes projekteve të tyre ndihmojnë në punësimin e punëtorëve përmes participimit me të ardhurat personale të tyre.

Po ashtu në këtë Rajon vlerësimet janë se mundësitë për punësim janë shumë të vogla bazuar në zhvillimin ekonomik të ulët të Kosovës në përgjithësi, pastaj ekonomia e shkatërruar nga lufta, investimet shumë të pakta nga investitorët e jashtëm dhe mungesa e kreditimit. Kjo sipas këtyre vlerësimeve ndodh për shkak të mosdefinimit të statusit të Kosovës ku edhe problematika dhe efektshmëria e tregut të punës do të rregullohej.

Ndërsa mundësitë e punësimit janë më të mëdha tek sektori privat dhe kryesisht aty po realizohet edhe pse jo në shkallën e kënaqshme. Në këtë kontekst roli i bankave do të ishte tejet i madh ngase përmes kreditimit ekonomia e vogël do të ringjallej me c'rast edhe punësimi do të rritej. Ose shprehur në disa sektorë që do të sillnin mundësitë më të mira për një menaxhim adekuat të papunësisë do të ishin përmes kreditimit, investimeve të jashtme dhe politikës së brendshme të vendit ku do të mund të vinte deri të gjenerimi i vendeve të reja të punës. Në këtë mes edhe procesi i privatizimit po të ishte me funksional do të kishte ndikimin e drejtpërdrejtë në punësimin dhe atë jo vetëm të pjesëtarëve të komunitetit serbë.

Po ashtu është vlerësuar se karakteristikë e tregut është se mungojnë kompanitë prodhuese ndërsa në anën tjetër bizneset e njëjta janë të shumëfishuara. Rrjedhimisht, mosfunksionimi i industrisë dhe metalurgjisë së rendë është po ashtu njëri ndër shkaktarët kryesorë që menaxhimi i papunësisë është i ultë duke qenë se këta dy sektorë do të duhej të futnin nën gjirin e tyre numrin më të madh të të papunëve.

6. REKOMANDIME

Rezultatet e përmbledhura në këtë raport kanë nxjerrë fakte interesante sa i përket menaxhimit të papunësisë dhe hulumtimit të papunësisë në Komunitetin serb. Duke u bazuar në rezultatet e këtij raporti si dhe të dhënave të mbledhura në terren kemi dalë më disa rekomandime të cilat do t'i paraqesim në vijim.

Qëllimi i këtyre rekomandimeve është që të shërbejnë si orientim për të gjitha ata të cilët dëshirojnë të ndër marrin hapa në drejtim të zgjidhjes së problemit të papunësisë dhe menaxhimit me të mirë të këtij problemi në të ardhmen.

Rekomandimet e dala nga ky raport janë:

Në bazë të të dhënave dhe vlerësimeve që ka nxjerr ky projekt vërehet se ka raste të shumta kur vendet e rezervuara për pjesëtarët e komunitetit serbë kanë mbetur të paplotësuara. Raste të tilla ka më së shumti nëpër Kuvendet Komunale të Kosovës.

REKOMANDIM:

Të realizohet një fushatë senzibilizuese lidhur me plotësimin e vendeve të punës të cilat kanë mbetur të zbraztë për pjesëtarët e komunitetit serbë, në mënyrë që këto vende të punës të cilat janë të rezervuara për këtë komunitet të plotësohen sa me shpejt. Këtë veprim mund ta ndër marrin Komunitat dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në Kosovë (MAPL).

Gjatë këtij viti ka pasur një iniciativë nga ana e Qeverisë së Kosovës që të punësohet një numër i caktuar i komunitetit serbë në Kompani Publike siç janë KEK, PTK etj. , por kjo iniciativë siç duket nuk është realizuar deri në fund.

REKOMANDIM:

Duhet të bëhet një sistemim më i mirë i vendeve të punës dhe hulumtimi i mundësisë për punësimin e komuniteteve pakicë në sektorin publik në përgjithësi e sidomos në Kompani të mëdha siç janë Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Posta dhe Telekomit i Kosovës (PTK) dhe kompani tjera të rëndësishme publike. Ky veprim mund të bëhet nga Qeveria e Kosovës dhe Institucionet Ndërkombëtare në Kosovë

Mungesa e një programi mbi punësimin sezonal është një ndër faktorët që ka ndikuar në mos zbutjen e papunësisë së madhe në Kosovë. Po të ekzistonte një sistem apo mundësi e tillë edhe në Kosovë, atëherë kjo do të ndikonte në masë të madhe në zbutjen e papunësisë dhe rrjedhimisht edhe të varfërisë në Kosovë.

REKOMANDIM:

Në të gjitha programet që kanë të bëjnë me punësim duhet t'i jepet përparësi edhe komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë, e sidomos komunitetit serb i cili jeton në Kosovë duke pasur parasysh që kjo ndihmon integrimin më të mirë të tyre në jetën politiko-shoqërore të vendit.

Duke u bazuar në të dhënat e këtij hulumtimi, del që punësimi i komunitetit serb në ndërmarjet e privatizuara dhe në sektorin privat është shumë e vogël, me përjashtim të rajonit të Gjilanit i cili qëndron me mirë në këtë drejtim.

REKOMANDIM:

Kërkohet që të ndryshohet qasja e deritanishme ndaj punësimit të komuniteteve në sektorin privat e sidomos në ndërmarrjet e privatizuara të cilat duhet ta kenë si kusht punësimin e një përqindje të caktuar të komuniteteve të ndryshme në këto ndërmarje. Përgjegjës për këtë veprim duhet të jenë Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM) dhe IPVQ-të Kosovare.

